



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 55/11 prot.

Vlorë, më 07.06.2021

VENDIM
Nr. 28, datë 07. 06. 2021

PËR
PROBLEMATIKËN NË DIPLOMAT E PLOTËSUARA GABIM TË STUDENTËVE
TË DIPLOMUAR NË PROGRAMIN E STUDIMIT "BACHELOR NË GJUHË
ANGLEZE" NË VITIN AKADEMIK 2018- 2019 NË FAKULTETIN E SHKENCAVE
HUMANE

Në mbështetje të nenit 38, 91 e vijues të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, 71 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe në vijim të Vendimit të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë nr. 16, datë 01. 06. 2021, Senati Akademik në mbledhjen e datës, 07. 06. 2021

VENDOSI:

1. Të shpallë si të pavlefshme diplomat e lëshuara në programin e studimit "Bachelor në gjuhën angleze", në vitin akademik 2018- 2019, të konstatuara me gabime në numrin e maturës shtetërore.
2. Të ngarkojë Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë për ndjekjen e procedurës për njoftimin e studentëve në qëllim depozitimin pranë Kryesekretares së fakultetit të diplomave të konstatuara me gabime, për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimit të tyre.
3. Pas asgjësimit të diplomave, të gjithë studentët sipas listës emërore të përgatitur nga Dekanati, të pajisen me diploma të reja ku të pasqyrohet numri i saktë i maturës shtetërore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

